



01-1032

|   |  |  |
|---|--|--|
|  | <p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b><br/>Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b><br/>Opština Priština – Municipality of Prishtina</p> | <p style="text-align: center;">PRISHTINA</p>  |
|---|--|--|

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-137161/22 dt. 15.06.2022, të kërkuësve / bashkëpronarëve, Miradije Hoti, Nexhmije Reçica, Naser Prapashtica, Mustafa Mustafi, Isa Mustafa dhe Enver Beha nga Prishtina dhe Investitorit “G-Goat Group” sh.p.k. nga Prishtina, dhe me përfaqësues, Remzi Gashi nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, e ndërtuara, në kuadër të bllokut urbanistik “T3”, të Planit Rregullues “Tophane”, në rr. “Ilir Konushevc” dhe “Hazir Mala” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizimit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 15.11.2022, lëshon këtë:

### CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** kërkuësve / bashkëpronarëve, Miradije Hoti, Nexhmije Reçica, Naser Prapashtica, Mustafa Mustafi, Isa Mustafa dhe Enver Beha nga Prishtina dhe Investitorit “G-Goat Group” sh.p.k. nga Prishtina, dhe me përfaqësues / bashkëpronar, Remzi Gashi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-137161/22 dt. 15.06.2022, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+10, e ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351/05-148594/19 dt. 15.10.2019, në parcelën kadastrale nr. 10274-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10274-0, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urbanistik urbanistik “T3”, të Planit Rregullues “Tophane”, në Prishtinë.

**II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Ilir Konushevc” ku ka dalje hyrjet me numrat: 147,153 dhe në rrugën “Qamile Jaka” ku ka dalje hyrjet me numrat: 4, 12, 14, 16 në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Kërkuësit / bashkëpronarët, Miradije Hoti, Nexhmije Reçica, Naser Prapashtica, Mustafa Mustafi, Isa Mustafa dhe Enver Beha nga Prishtina dhe Investitorit “G-Goat Group” sh.p.k. nga Prishtina, dhe me përfaqësues Remzi Gashi nga Prishtina, me kërkesën 05 Nr. 391/02-137161/22 dt. 15.06.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+10, e ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “T3”, të Planit Rregullues “Tophane”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10274-0, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e Ndërtimit, 05 Nr. 351/05-148594/19 dt. 15.10.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprkishtë Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit, e Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-278589/21 dt. 11.05.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspeksionit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuësit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista

Faqe 1 prej 2

kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Florian Shala; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Dorentina Elshani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Besart Osmanaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Faruk Shalla; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Vehbi Abdullahaj; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Driton Haziri me nr. të licensës 177;

Drejtorja e Urbanizmit, pas pranimit të kësaj kërkesë dhe shqyrtimit të saj, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.


Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certifikate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-137161/22 DT. 15.11.2022**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  


U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi  


Drejtori,  
Arber Sadiki  